



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE  
PËR PERIUDHËN JANAR/QERSHOR - 2024**

KORRIK/2024

## P Ë R M B A T J A

1. Hyrja.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	6
3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike .....	8
4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.....	11
4.1 Paga dhe shtesa .....	11
4.2 Mallërat dhe shërbimet.....	15
4.3 Shpenzime komunale.....	18
4.4 Subvencionet dhe transferet.....	19
4.4 Shpenzimet kapitale.....	20
5. Të hyrat vetanake.....	21
6. Të hyrat nga donacionet.....	24

## 1. H Y R J E

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 me Nr. 08/L-260, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutit të Universitetit të Mitrovicës neni 29 përgjegjësitë e rektorit pika 1.9 lidhur me menaxhimin e buxhetit dhe mjeteve, rektori i Universitetit të Mitrovicës përmes zyrës për buxhet dhe financa ka hartuar raportin mbi planifikim dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar/qershor të vitit fiskal 2024.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të planifikuara të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2025/2027, Planin Strategjik për Universitetin “ Isa Boletinit “ në Mitrovicë për vitet 2022/2025, vendimeve nga niveli qendror: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe aktiviteteve të pasqyruara sipas planit të rrjedhës së parasë për vitin fiskal 2024.

Raporti, përmes pasqyrave financiare, pasqyron se në ç’mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2024, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet.

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 të hartuar nga Qeverija e Republikës së Kosovës.
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 të hartuar nga UIBM.
4. Ligji mbi Ndarjet Buxhetore për Republikës së Kosovës për vitin 2024.
5. Statuti i UIBM.
6. Plani Strategjik për vitet 2022/2025 për UIBM.
7. Buxheti për vitin 2024 për UIBM.
8. Ligji nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik.
9. Plani i prokurimit për UIBM për vitin fiskal 2024.
10. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2024 për UIBM

Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

## BUXHETI PËR VITIN 2024

Buxheti për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin me Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 është 3,567,551 € që në krahasim me buxhetin e vitit 2023 është me i ulët për 284,908.00 € ose me indeks prej 7.40 %.

Buxheti për Universitetin e Mitrovicës për vitin 2024 në krahasim me Ligjin mbi buxhetin për vitin 2023 ka pësuar ndryshime në kategoritë ekonomike: paga dhe shtesa, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale.


Masa buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe shtesa është zvogëluar për 589,908.00 €, ndërsa në kategorinë ekonomike subvencionet dhe transferet është rritur masa buxhetore për 85,000.00 € dhe po ashtu ka rritje në kategorinë ekonomike shpenzimet kapitale për 220,000.00 €. Buxheti për kategoritë tjera është në nivel të vitit buxhetor 2023.

Burimet e financimit sipas në Buxhetin final janë: nga buxheti i Kosovës në shumë prej 3,537,078.00 € dhe 30,473.00 € nga të hyrat vetanake. Të hyrat e planifikuara vetanake në krahasim me vitin 2023 janë të nivelit të njëjtë buxhetor.

Kufijtë final për vitin 2024 të strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit:

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2024	Burimet e financimit	
			Granti Qeveritar (GQ)	Të hyrat vetanake
1	PAGA DHE SHTESA	2,304,197.00	2,273,724.00	30,473.00
2	MALLËRAT DHE SHËRBIMET	543,154.00	543,154.00	
3	SHPENZIMET KOMUNALE	215,200.00	215,200.00	
4	SUBVENCIONE DHE TRANSFERET	185,000.00	185,000.00	
5	SHPENZIMET KAPITALE	320,000.00	320,000.00	
<b>GJITHSEJ</b>		<b>3,567,551.00</b>	<b>3,537,078.00</b>	<b>30,473.00</b>

**Tabela 1.** Kufijtë final për vitin 2024 të strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit.



**Figura 1.** Buxheti për vitin fiskal 2024.

**Paga dhe shtesa** - masa buxhetore për përmbushjen e obligimeve në kategorinë ekonomike për paga dhe shtesa është 2,304,197.00 € që është për **589,908.00 € më i ulët në krahasim me buxhetin e vitit 2023.**

**Mallërat dhe Shërbimet** - masa buxhetore për këtë kategori është 543,154.00 € dhe është në nivelin e njëjtë të vitit fiskal 2023.

**Shpenzimet Komunale** - masa buxhetore për këtë kategori është 215,200.00 € dhe është në nivelin e njëjtë të vitit fiskal 2023.

**Subvencionet dhe Transferet** - mjetet e planifikuara në këtë kategori ekonomike janë në shumë prej 185,000.00 €, më e lartë prej 85,000.00 € në krahasim me buxhetin e vitit 2023.

**Shpenzimet Kapitale** - shpenzimet kapitale për këtë vit fiskal janë planifikuar në shumë prej 320,000.00 € dhe janë më të larta për 220,000.00 € në krahasim me buxhetin e vitit 2023.

## 2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin me Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 është 3,567,551.00 € që në krahasim me buxhetin e vitit 2023 është me i ulët për 284,908.00 € ose me indeks prej 7.40 %.

Për periudhën raportuese (janar-qershor) janë alokuar mjete në shumë prej 2,231,362.88 € ose 62.55% të buxhetit të aprovuar. Realizmi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 66.40 % (1,481,604.73 €) bazuar në alokimin e mjeteve ose me indeks prej 41.53 % në krahasim me buxhetin e aprovuar vjetor. Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 1,909,044.68 € ose 85.56 % të mjeteve të alokuara.

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme për të njëjtën periudhë. Planifikimi i aktiviteteve për funksionalizim të kampusit të ri universitar, ngritja e nivelit të shërbimeve për student ishin prioritete të përcaktuara nga menaxhmenti. Buxheti i planifikuar është ndërlidhur me objektivat dhe aktivitetet e pasqyruara në Planin Strategjik për vitet 2022/2025 për UIBM. Ndarja e mjeteve pasqyron përkushtimin për funksionalizim të kampusit, furnizim me paisje për teknologji informative, kompjuter, paisje për laboratorë të njësive akademike si dhe shpenzimet për angazhimin e ekspertëve të jashtëm në procesin e riakreditimit institucional dhe programeve të njësive akademike.

Për periudhën raportuese MFPT përmes MASHTI ka bërë alokimin e buxhetit të aprovuar për periudhën raportuese për të gjitha kategoritë ekonomike, përjashtimisht buxhetin për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje. Zyra për buxhet dhe financa bazuar në përgjegjësitë do të përqendrohet në realizimin e aktiviteteve konform planit të rrjedhës së parasë dhe dinamikës së përcaktuar për alokim dhe realizim për vitin fiskal 2024.

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar-Qershor/2024 në indeks të realizimit prej 66.40 % të mjeteve të alokuara mund të karakterizohet si i suksesshëm për faktin:

1. Aprovimit me vonesë i planit të rrjedhës së parasë për vitin 2024
2. Alokimit me vonesë të buxhetit nga ana e MFPT
3. Zvogëlimi i masës buxhetore për mbulimin e obligimeve në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa për vitin fiskal 2024.
4. Procedurat e tej zgjatura të prokurimit për realizim të mjeteve të alokuara/mallërat dhe shërbime dhe shpenzimet kapitale.
5. Zbatimit të Ligjit mbi pagat për sektorin publik.
6. Mungesa e rregullorës për të ardhurat personale të personelit akademik, shtesat sipas funksioneve dhe kompenzimet tjera në UIBM.
7. Vendimeve gjygjësore përmbarimore.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar planifikimi, alokimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën raportuese janar-qershor/2024.

<b>Buxheti i planifikuar i bazuar në Ligjin mbi buxhetin për 2024</b>	<b>Alokimi Janar-Qershor/2024</b>	<b>Mjetet e shpenzuara Janar-Qershor/2024</b>	<b>Indeksi i realizimit në raport me Ligjin e aprovuar mbi buxhetin 2024</b>	<b>Indeksi i realizimit në raport me alokimin e mjeteve</b>
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4=3/1*100</b>	<b>5=3/2*100</b>
3,567,551.00	2,231,362.88	1,481,604.73	41.53	66.40

**Tabela 2.** Pasqyra e planifikimit, alokimit dhe realizimit të buxhetit për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024.

### 3. PASQYRA E REALIZIMIT TË BUXHETIT E STRUKTURUAR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare pasqyron: si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikimin, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

Për periudhën raportuese janar-qershor/2024 janë alokuar mjete në shumë prej 2,231,362.88 € ose 62.55 % të buxhetit të aprovuar. Realizimi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 66.40 % (1,481,604.73 €) bazuar në alokimin e mjeteve ose me indeks prej 41.53 % në krahasim me buxhetin e aprovuar vjetor. Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 1,909,044.68 € ose 85.56 % të mjeteve të alokuara.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokim, realizim dhe indeks të realizimit.

Kategoritë ekonomike	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2024	Alokimi Janar-Qershor/2024	Mjetet e shpenzuara Janar-Qershor/2024	Zotimet/obligimet në pritje	Mjetet e angazhuara	Mjetet e pashfrytëzuara	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
	1	2	3	4	5=3+4	6=2-5	7=5/2*100	8=3/2*100
Paga dhe Shtesa	2,304,197.00	1,235,686.18	1,214,114.34	-	1,214,114.34	21,571.84	98.25	98.25
Mallërat dhe Shërbimet	543,154.00	491,276.70	189,425.60	117,439.95	306,865.55	184,411.15	62.46	38.56
Shpenzimet Komunale	215,200.00	119,400.00	74,464.79	-	74,464.79	44,935.21	62.37	62.37
Subvencionet dhe Transferet	185,000.00	65,000.00	3,600.00	-	3,600.00	61,400.00	5.54	5.54
Investimet Kapitale	320,000.00	320,000.00	-	310,000.00	310,000.00	10,000.00	96.88	-
<b>Total</b>	<b>3,567,551.00</b>	<b>2,231,362.88</b>	<b>1,481,604.73</b>	<b>427,439.95</b>	<b>1,909,044.68</b>	<b>322,318.20</b>	<b>85.56</b>	<b>66.40</b>

**Tabela 3.** Pasqyra e realizimit të buxhetit i krahasuar me burime, alokim, realizim dhe indeks të realizimit për periudhën Janar-Qershor/2024.





**Figura 2.** Indeksi i realizimit të mjeteve në raport me indeksin e alokimit të mjeteve.

**Pagat dhe shtesa** - janë alokuar 1,235,686.18 € për përmbushjen e obligimeve për paga për personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelin administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar 1,214,114.34 € ose me indeks të realizimit prej 98.25 % përkatësisht janë shpenzuar mjete me indeks prej 52.69 % të mjeteve të planifikuara (2,304,197.00 €) sipas buxhetit të aprovuar.

**Mallërat dhe shërbimet** - bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar 491,276.70 € ose 90.45 % të buxheti të aprovuar (543,154.00 €). Mjetet e alokuara janë realizuar në shumë prej 189,425.60 € euro ose me indeks prej 38.56 % në krahasim me mjetet e alokuara.

**Shpenzimet Komunale** - janë alokuar 119,400.00 € ose me indeks prej 55.48 % në raport me mjetet e planifikuara (215,200.00€) dhe janë realizuar 74,464.79 € ose me indeks prej 62.37 % në krahasim me mjetet e alokuara.

**Subvencionet dhe transferet** - janë alokuar 65,000.00 € ose me indeks prej 35.14 % në raport me mjetet e planifikuara (185,000.00€) dhe janë realizuar 3,600.00 € ose me indeks prej 5.54 % në krahasim me mjetet e alokuara.

**Shpenzimet Kapitale** - sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar 320,000.00 € me indeks prej 100.00 % në raport me mjetet e planifikuara (320,000.00€) dhe janë realizuar 0.00 € ose me indeks prej 0.00 % në krahasim me mjetet e alokuara, mirëpo këto mjete të alokuara janë zotuar dhe kanë filluar me procedurat e prokurimit.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar alokimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024 në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë të vitit fiskal 2022/2023.

Kategoritë ekonomike	Alokimi Janar-Qershor/2022	Alokimi Janar-Qershor/2023	Alokimi Janar-Qershor/2024	Mjetet e shpenzuara Janar-Qershor/2022	Mjetet e shpenzuara Janar-Qershor/2023	Mjetet e shpenzuara Janar-Qershor/2024	Indeksi 2022	Indeksi 2023	Indeksi 2024
	1	2	3	4	5	6	$7=4/1 * 100$	$8=5/2 * 100$	$9=6/3 * 100$
Paga dhe Shtesa	1,410,968.64	1,495,024.53	1,235,686.18	1,295,765.79	1,198,520.13	1,214,114.34	91.84	80.17	98.25
Mallërat dhe Shërbimet	543,154.00	424,496.88	491,276.70	207,856.43	172,449.04	189,425.60	38.27	40.62	38.56
Shpenzimet Komunale	215,200.00	136,010.40	119,400.00	107,574.41	91,859.21	74,464.79	49.99	67.54	62.37
Subvencionet dhe Transferet	100,000.00	25,000.00	65,000.00	9,766.85	2,284.15	3,600.00	9.77	9.14	5.54
Investimet Kapitale	350,000.00	100,000.00	320,000.00		29,912.00	-	-	29.91	-
Total	2,619,322.64	2,180,531.81	2,231,362.88	1,620,963.48	1,495,024.53	1,481,604.73	61.88	68.56	66.40

**Tabela 4.** Pasqyra e alokimit dhe realizimit të buxhetit për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024 në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë të vitit fiskal 2022/2023.

#### **4. SHPALOSJA E PASQYRAVE TË SHPENZIMEVE TË STRUKTURUARA NËPËR KATEGORI EKONOMIKE**

##### **4.1 PAGA DHE SHTESA**

Bazuar në strukturën organizative, Ligjin mbi pagat për shërbyesit publik, numrin e planifikuar sipas Ligjit mbi ndarjen buxhetore për vitin fiskal 2024, buxheti i kategorisë ekonomike Paga dhe shtesa për vitin fiskal 2024 është zvogëluar në shumë prej 886,490.00 € në krahasim me planifikimin buxhetor sipas Qarkores së parë buxhetore 2024/01, KASH 2024/2026 dhe 589,908.00 € në krahasim me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2023. Buxheti për paga dhe shtesa sipas Qarkores së parë ishte 3,190.686.00 € e strukturuar sipas strukturës organizative dhe numri të lejuar(199) sipas ndarjeve buxhetore që nga viti fiskal 2019. Buxheti për vitin fiskal 2024 në shumë prej 2,304.197.00 € është planifikuar të mbulon obligimet ndaj numrit të lejuar prej 199 të punësuarëve sipas Qarkores së dytë buxhetore të planifikuar sipas strukturës organizative dhe sistematizimin e vendeve të punës. Buxheti i planifikuar nuk është i përputhur me numrin e lejuar sipas Qarkores së dytë buxhetore, buxheti për paga mbulon vetëm 162 vende të punës duke lënë anash numrin prej 37 të personelit akademik dhe administrativ të pa sistemuar. **Shuma totale buxhetore e pa mbuluar për paga për vitin fiskal 2024 është 429,104.34 €.**

Kjo masë buxhetore për vitin fiskal 2024 nuk mbulon të gjitha pozitat e planifikuara sipas strukturës organizative për personel akademik, administrativ dhe anëtar të KD.

Një tjetër sfidë e cila është duke e rënduar edhe më tepër këtë kategori ekonomike dhe buxhetin e UIBM për vitin fiskal 2024 janë pagesat të cilat po ekzekutohen nga thesari të formës së prerë të vendimeve gjyqësore-përmbartimore të dalura nga kontratat kolektive dhe të tjera.

Në periudhën Janar-Qershor/2024 janë ekzekutuar nga thesari 71,050.21 € sipas vendimeve gjyqësore-përmbartimore të dalura nga kontratat kolektive dhe të tjera.

Prandaj, të gjitha këto vështirësi në buxhetin e kësaj kategorije ekonomike për vitin fiskal 2024 do të reflektohen në zhvillim të procesit mësimor, por edhe në shërbimet administrative që do të ofrohen për student, njësitë akademike dhe administrat në përgjithësi.

Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa (paga mars/2024)

Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa - Universiteti i Mitrovicës - paga mars/2024										
Kodi i programit	MASHTI	Nr. i aprovuar sipas Ligjit mbi Buxhetin vitin 2024	Numri aktual i të punësuarve: KD, personel akademik i rregullt - paga mars/2024	Numri aktual i të punësuarve - personeli akademik i angazhuar - paga mars/2024	Numri aktual i të punësuarve për personelin administrativ - paga mars/2024	Numri aktual i të punësuarve për personelin: KD, akademik i rregullt, i angazhuar dhe p. Administrativ - paga mars/2024	Vendet e lira në krahasim me numrin e lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2024	Vende të lira për personel akademik	Vendet e lira për personel administrativ	Tejkallim te numrit te lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2024
		1	2	3	4	5=2+3+4	6=1-(2+3+4)	7	8	9
97900	UIBM	199	104	31	61	196	3	3	0	0
Totali:		199	104	31	61	196	3	3	0	0

**Tabela 5.** Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa (paga mars/2024)

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i pagave për periudhën Janar-Qershor/2024 në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në Ligjin mbi ndarjen buxhetore për vitin 2024	Alokimi e mjeteve për paga për periudhën Janar- Qershor/2024	Pagat e realizuara për periudhën Janar-Qershor/2024	Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për Janar-Qershor/2024
		1	2	3	4=3/2*100
1	PAGA DHE SHITESA	2,304,197.00	1,235,686.18	1,214,114.34	98.25

**Tabela 6.** Pasqyra e realizimit të pagave për periudhën Janar-Qershor/2024 në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë.

Sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese janë alokuar mjete prej 1,235,686.18 €, kurse janë shpenzuar 1,214,114.34 €. Mjetet janë realizuar me indeks prej 98.25 % në krahasim me mjetet e alokuara.

Nr.	Planifikimi i pagave për periudhën janar/qershor të bazuar në planin e rrjedhës së parasë për vitin 2024	Alokimi i mjeteve për periudhën janar-qershor/2024	Realizimi i pagave për periudhën janar-qershor/2024	Mbetja e buxhetit për periudhën janar-qershor/2024
	1	2	3	4=2-3
1	1,235,686.18	1,235,686.18	1,214,114.34	21,571.84

**Tabela 7.** Pasqyra e planifikimit, alokimit dhe realizimit të pagave për periudhën Janar-Qershor/2024.

Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UIBM.

Nr.	UIBM	Personeli administrativ	Shuma	Personel Akademik	Shuma	Personel akademik i	Shuma	Anëtar i Këshillit Drejtues - te	Shuma	Totali	Totali
1	JANAR	62	43,886.11	102	148,483.49	19	602.11	0	-	183	192,971.71
2	SHKURT	62	44,156.05	101	139,676.53	18	-	3	950.97	184	184,783.55
3	MARS	61	43,539.75	101	137,995.47	31	13,388.11	3	970.20	196	195,893.53
4	PRILL	60	42,142.21	101	144,301.55	34	7,528.79	3	970.20	198	194,942.75
5	MAJ	59	43,703.80	100	142,643.35	34	5,250.23	3	970.20	196	192,567.58
6	QERSHOR	59	42,518.94	101	138,226.83	34	189.04	3	970.20	197	181,905.01
7	Permbaruesi/kontrata kolektive, te tjera										71,050.21
Gjithsej			259,946.86		851,327.22		26,958.28		4,831.77		1,214,114.34


**Tabela 8.** Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UIBM.

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 851,327.22 € janë realizuar për personelin akademik ose 74.48 % të totalit të realizuar (1,143,064.13 €), për personelin akademik të angazhuar janë realizuar 26,958.28 € euro ose 2.36 % dhe për personelin administrativ të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 259,946.86 € ose 22.74 %, shuma prej 4,831.77 € për Anëtarët e Këshillit Drejtues - të jashtëm ose 0.42 % dhe sipas vendimeve të gjykatës/përmbauesi për mos ekzekutimin e kontratave kolektive në shumë prej 71,050.21 € ose 5.85 % të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese(1,214,114.34 €).

Pasqyra e realizimit të pagave të strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë.

Njësia akademike	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
KËSHILLI DREJTUES - të jashtëm	-	950.97	970.20	970.20	970.20	970.20	4,831.77
FGJ	47,581.32	45,260.23	49,802.40	46,764.67	46,830.27	43,746.17	279,985.06
FIMK	32,826.14	33,054.79	37,137.67	37,531.54	35,769.97	32,017.30	208,337.41
FTU	30,952.85	29,428.39	30,476.09	30,643.68	30,596.88	30,476.83	182,574.72
EDUKIM	24,571.18	20,788.12	21,404.66	23,009.67	22,542.63	20,948.63	133,264.89
JURIDIK	15,804.29	15,261.36	16,727.77	15,624.92	15,404.09	14,825.51	93,647.94
EKONOMIK	15,580.37	14,114.23	14,161.68	15,472.15	14,726.68	13,986.43	88,041.53
REKTORATI	25,655.57	25,925.46	25,213.06	24,925.93	25,726.87	24,933.93	152,380.82
Vendime gjyqësore/përmbauesi	-	20,182.68	-	-	50,867.53	-	71,050.21
TOTALI	192,971.71	204,966.23	195,893.53	194,942.75	243,435.12	181,905.01	1,214,114.34

**Tabela 9.** Pasqyra e realizimit të pagave të strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë.



**Figura 3.** Pasqyra e realizimit të pagave të strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë.

Pasqyra krahasuese e realizimit të pagave për vitet 2022/2024

Nr.	Periudha e raportimit	Paga e realizuar	Indeksi i realizimit
1	Periudha janar-qershor/2022	1,295,765.80	91.83
2	Periudha janar-qershor/2023	1,198,520.00	80.17
3	Periudha janar-qershor/2024	1,214,114.34	98.25

**Tabela 10.** Pasqyra krahasuese e realizimit të pagave për vitet 2022/2024.

## 4.2 MALLËRAT DHE SHËRBIMET

Për periudhën raportuese janar-qershor/2024 janë alokuar 491,276.70 €, janë realizuar 189,425.60 € dhe janë zotuar 117,439.95 €. Për periudhën raportuese janë angazhuar 306,865.55 € ose me indeks të angazhimit prej 62.46 % më krahasim me mjetet e alokuara.

Pasqyra e planifikimit, alokimit, shpenzimit, zotimit dhe indeksi i realizimit për periudhën Janar-Qershor/2024

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve sipas buxhetit për 2024	Alokimi i mjeteve-janar-qershor/2024	Mjetet e shpenzuara-janar-qershor/2024	Mjetet e zotuar janar/qershor/2024	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1	MALLRA DHE SHËRBIME	543,154.00	491,276.70	189,425.60	117,439.95	38.56

**Tabela 11.** Pasqyra e planifikimit, alokimit, shpenzimit, zotimit dhe indeksi i realizimit për periudhën Janar-Qershor/2024.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike dhe nën kode ekonomike sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën janar-qershor/2024.

KODI EKONOMIK	KATEGORIA EKONOMIKE	MJETET E PLANIFIKUARA 2024	ALOKIMI I MJETEVE JANAR-QERSHOR/2024	SHPENZIMI I MJETEVE JANAR-QERSHOR/2024	ZOTIMI I MJETEVE JANAR-QERSHOR/2024	MJETET E ANGAZHUARA JANAR-QERSHOR/2024
		1	2	3	4	5=3+4
<b>13000</b>	<b>MALLËRAT DHE SHËRBIMET</b>	<b>543,154.00</b>	<b>491,276.70</b>	<b>189,425.60</b>	<b>117,439.95</b>	<b>306,865.55</b>
13100	Shpenzimet e udhëtimit	-	-	9,783.69	364.47	10,148.16
13130	Transporti për udhëtime zyrtare brenda vendit			942.30	57.70	1,000.00
13131	Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare brenda vendit					-
13132	Akomodimi për udhëtimet zyrtare brenda vendit					-
13134	Transporti për punë në terren					-
13140	Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit			3,693.23	306.77	4,000.00
13141	Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit			3,057.48		3,057.48
13142	Akomodimi për udhëtimet zyrtare jashtë vendit			1,973.95		1,973.95
13143	Shpenzimet e tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendit			116.73		116.73
13300	Shërbimet e telekomunikimit	17,300.00	11,522.70	4,184.00	1,131.00	5,315.00
13310	Shpenzimet për Internet	1,800.00	1,050.00	314.00	1,131.00	1,445.00
13320	Shpenzime e telefonisë mobile	15,000.00	10,200.00	3,870.00		3,870.00
13330	Shpenzimet postare	500.00	272.70			-
13340	Shpenzimet për përdorim të kabllot optik					-
13400	Shpenzimet për shërbimet	206,228.00	192,728.00	87,250.85	23,529.83	110,780.68
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	20,000.00	15,000.00			-

13440	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	5,000.00	4,000.00			-
13440	Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale	5,000.00	5,000.00			-
13441	Shërbime të veçanta	23,054.00	23,054.00			-
13450	Shërbimet e shtypjes/printimit	10,000.00	8,000.00	2,118.63	1,322.45	3,441.08
13460	Shërbime kontraktuese të tjera	60,000.00	58,000.00	49,829.84	230.40	50,060.24
13470	Shërbimet teknike	1,500.00	1,500.00			-
13471	Softuerët - licencat dhe mirëmbajtja e tyre	8,000.00	8,000.00	1,931.00	7,068.90	8,999.90
13475	Sigurimi fizik i objekteve publike	67,674.00	67,674.00	32,783.38	14,908.08	47,691.46
13480	Shpenzimet për anëtarësim	6,000.00	2,500.00	588.00		588.00
13495	Pagesa për Vendime Gjyqësore					-
13500	Blerja e mobilie dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro	100,000.00	100,000.00	19,801.00	55,000.00	74,801.00
13501	Mobiljet	30,000.00	30,000.00	18,814.00		18,814.00
13503	Kompjuterët	45,000.00	45,000.00		30,000.00	30,000.00
13504	Pajisjet e tjera të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	17,000.00	17,000.00		17,000.00	17,000.00
13509	Pajisjet e tjera			987.00		987.00
13510	Blerja e librave dhe veprave artistike	8,000.00	8,000.00		8,000.00	8,000.00
13600	Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	26,500.00	18,500.00	815.35	7,961.50	8,776.85
13610	Furnizime për zyrë	10,000.00	7,000.00		990.00	990.00
13611	Furnizim me dokumente blanko	2,000.00	-			-
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	2,000.00	1,000.00	815.35		815.35
13640	Furnizime pastrimi	500.00	500.00			-
13655	Furnizim me preparate kimike	7,000.00	7,000.00		6,971.50	6,971.50
13660	Akomodim për mikpritje të delegacioneve të jashtme	5,000.00	3,000.00			-
13700	Derivatet dhe lëndët djegëse	4,000.00	2,500.00	1,407.55	141.65	1,549.20
13780	Karburant për vetura	4,000.00	2,500.00	1,407.55	141.65	1,549.20
13800	Llogarite e avansit	16,000.00	10,000.00	2,030.00	-	2,030.00
13810	Avancë për para të imta	2,000.00	1,000.00	500.00		500.00
13820	Avancë për udhëtime zyrtare	12,000.00	8,000.00	1,530.00		1,530.00
13822	Avancë për arsim dhe trajnime për MM	2,000.00	1,000.00			-
1395	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	3,600.00	-	-	-	-
13951	Sigurimi i automjeteve	3,100.00	-			-
13952	Taksa komunale për regjistrim të automjeteve	500.00	-			-
13954	Kontrollimi teknik i automjeteve	-	-			-
14000	Mirëmbajtja	143,240.00	141,240.00	60,667.46	28,561.60	89,229.06
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00	2,000.00		990.00	990.00
14023	Mirëmbajtja e objekteve arsimore	96,240.00	96,240.00	43,847.46	11,677.08	55,524.54
14040	Mirëmbajtja e teknologjisë informativë (harduerë)	40,000.00	40,000.00	16,820.00	14,899.52	31,719.52
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	2,500.00	1,500.00		995.00	995.00
14060	Mirëmbajtja rutinore	2,000.00	1,500.00			-
14200	Shpenzimet e marketingut	15,000.00	9,000.00	720.00	-	720.00



14210	Reklamata dhe konkurset	5,000.00	3,000.00			-
14220	Botimet e publikimeve	5,000.00	3,000.00			-
14230	Shpenzimet për informim publik	5,000.00	3,000.00	720.00		720.00
14300	Shpenzimet e përfaqësimit	11,286.00	5,786.00	2,765.70	749.90	3,515.60
14310	Kompenzimi i përfaqësimit brenda vendit	11,286.00	5,786.00	2,765.70	749.90	3,515.60

**Tabela 12.** Pasqyra e shpenzimeve të strukturuar në kategorinë ekonomike Mallëra dhe shërbimet nëpër kode ekonomike dhe nën kode ekonomike sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën janar-qershor/2024.

Bazuar në planin e rrjedhës së parasë për këtë periudhë janë planifikuara disa nga aktivitetet që i takojnë kësaj kategorije si: angazhimi i ekspertëve të jashtëm në procesin e riakreditimit të programeve të UIBM në shumë prej 50,000.00 €, paisje me inventar në shumë prej 20,000.00 €, mirëmbajtja e teknologjisë informative me 40,000.00 €, pajisjet e tjera të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit 17,000.00 €, kompjuter 30,000.00 etj.

Qëndrueshmëria e investimeve kapitale në kampusin universitar gërthen në vete edhe mirëmbajtjen dhe sigurimin e objekteve dhe për këtë është planifikuar shuma prej 163,914.00 €

Pasqyra krahasuese e realizimit të mallërave dhe shërbimeve për periudhën Janar-Qershor të viteve 2022/2024

Nr.	Periudha e raportimit	Realizimi	Indeksi i realizimit
1	Periudha janar-qershor/2022	207,866.43	38.27
2	Periudha janar-qershor/2023	172,449.04	40.62
3	Periudha janar-qershor/2024	189,425.60	38.56

**Tabela 13.** Pasqyra krahasuese e realizimit të mallërave dhe shërbimeve për periudhën Janar-Qershor të viteve 2022/2024.

### 4.3 SHPENZIMET KOMUNALE

Për këtë kategori është alokuar buxheti për periudhën Janar-Qershor/2024 në shumë prej 119,400.00 €, në të cilën kategori ekonomike janë realizuar mjete në shumë prej 74,464.79 € ose me indeks prej 62.37 %.

Pasqyra e planifikimit, alokimit dhe realizimit të buxhetit për kategorinë ekonomike shpenzime komunale për periudhën Janar-Qershor/2024

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2024	Alokimi i mjeteve Janar-Qershor/2024	Shpenzimet e realizuara Janar-Qershor/2024	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SHPENZIMET KOMUNALE	215,200.00	119,400.00	74,464.79	62.37

**Tabela 14.** Pasqyra e planifikimit, alokimit dhe realizimit të buxhetit për kategorinë ekonomike shpenzime komunale për periudhën Janar-Qershor/2024.

Në tabelën e poshtëshënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike dhe planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese.

Nr	Përshkrimi	Buxheti i planifikuar për vitin fiskal 2024	Alokimi i mjeteve Janar-Qershor/2024	Shpenzimet e realizuara Janar-Qershor/2024	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	Energjia Elektrike	103,000.00	64,000.00	28,247.27	44.14
2	Shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit	13,200.00	6,900.00	2,760.36	40.01
3	Mbeturinat	10,000.00	5,850.00	3,160.64	54.03
4	Ngrohja qendrore	84,000.00	40,000.00	37,836.00	94.59
5	Telefonia fikse	5,000.00	2,650.00	2,460.52	92.85
<b>Totali:</b>		<b>215,200.00</b>	<b>119,400.00</b>	<b>74,464.79</b>	<b>62.37</b>

**Tabela 15.** Pasqyra e shpenzimeve sipas kodeve ekonomike dhe planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024.

Pasqyra krahasuese e realizimit të shpenzimeve komunale për periudhën Janar-Qershor për vitet 2022/2024.

Nr.	Periudha e raportimit	Shuma e realizuar	Indeksi i realizimit
1	Periudha janar-qershor/2022	107,574.41	49.98
2	Periudha janar-qershor/2023	91,586.21	67.53
3	Periudha janar-qershor/2024	74,464.79	62.37

**Tabela 16.** Pasqyra krahasuese e realizimit të shpenzimeve komunale për periudhën Janar-Qershor për vitet 2022/2024.

#### 4.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për vitin fiskal 2024 në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transferove është në shumë prej 185,000.00 €, në krahasim me vitin 2023 kemi rritje prej 85,000.00 €. Këto mjete planifikohen të bëhen për stimulimin e studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa, stimulimi i autorëve për libra për universitetin/student si dhe stimulimi për personelin akademik për botimin e punimeve shkencore në revista prestigjioze.

Për periudhën raportuese janë alokuar mjete në shumë prej 65,000.00 €, janë realizuar 3,600.00 € ose me indeks prej 5.54 % në krahasim me buxhetin e alokuar. Këto shpenzime janë realizuar për pagesat e bursave të 4 studentëve të vitit të kaluar akademik 2022/2023.

Pasqyra e planifikimit, alokimit, realizimit për kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere për periudhën Janar-Qershor/2024.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar 2024	Alokimi i mjeteve Janar-Qershor/2024	Realizimi i buxhetit Janar-Qershor/2024	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	185,000.00	65,000.00	3,600.00	5.54

**Tabela 17.** Pasqyra e planifikimit, alokimit, realizimit për kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere për periudhën Janar-Qershor/2024.

#### 4.5 INVESTIME KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin fiskal 2024, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 320,000.00€ që në krahasim me vitin 2023 masa buxhetore është rritur për 220,000.00 €. Mjetet e planifikuara në shumë prej 320,000.00€ është ndarë për pajisjen e laboratorëve të njësive akademike, pajisje me teknologji informative e cila do të jetë në funksion të funksionimit të laboratorëve dhe ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës së objekteve të ndërtuara.

Pasqyra e planifikimit të investimeve kapitale të strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i projekteve	Shuma
1	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	Furnizimi me paisje të Inxhinierise Mekanike dhe Kompjuterike	130,000.00
2	Fakulteti i Gjeoshkencave	Furnizimi me pajisje për laboratorin për Teknologji ushqimore	60,000.00
3	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	Furnizimi me paisje për laborator të Gjeoshkencave	50,000.00
4	Rektorat/njësi akademike	Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative	70,000.00
5	Rektorat/njësi akademike	Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës së Universitetit të Mitrovicës	10,000.00
<b>Gjithsej:</b>			<b>320,000.00</b>

**Tabela 18.** Pasqyra e planifikimit të investimeve kapitale të strukturuar sipas njësive akademike dhe administratë.

Pasqyra e planifikimit, alokimit, zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar 2024	Alokimi i mjeteve Janar-Qershor/2024	Realizimi Janar-Qershor/2024	Zotimi i mjeteve Janar-Qershor/2024	Mjetet e angazhuara Janar-Qershor/2024	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3+4	6=3/2*100
	Investime kapitale	320,000.00	310,000.00	-	310,000.00	310,000.00	-

**Tabela 19.** Pasqyra e planifikimit, alokimit, zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024.

Për periudhën raportuese janë alokuar mjete në shumë prej 310,000.00 €, nuk kemi pasur realizim të mjeteve mirëpo këto mjete janë zotuar dhe kanë filluar procedurat e prokurimit për 4 projektet e para sipas tabelës së lartë cekur. Për shkak të procedurave të tejzgjatura të prokurimit (afateve, ofertimeve e deri në finalizimin e kontratës, periudhën e furnizimeve) dhe në fund ekzekutimin e tyre, planifikohet që në periudhën korrik/tetor të realizohen projektet të cilat kanë filluar në tremujorshin e parë të vitit fiskal 2024.

## 5. TË HYRAT VETANAKE

### 5.1. Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024

Planifikimi i të hyrave vetanake ishte i bazuar në numrin e studentëve aktiv, lartësinë/çmimet e përcaktuara sipas Udhëzimit administrativ të MASHTI-it me nr.09/2021 aplikimi i pagesave të studentëve në universitet publike, shitja e shërbimeve për persona fizik dhe juridik nga shërbimet e ofruara nga institutet e themeluara nga njësitë akademike dhe Qendra për Ndërmarrësi dhe Inovacione.

Të hyrat e planifikuara sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin fiskal 2024 mund të realizohen vetëm për përmbushjen e obligimeve për kategorinë ekonomike paga dhe shtesa dhe nuk mund të shpenzohen për qëllime tjera.

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024 e strukturuar sipas shërbime administrative të ofruara për studentët e UIBM bazuar në UA 09/2021 :

Nr.	EMËRTIMI I TË HYRAVE VETANAKE	Çmimi për shërbim
1	Vërtetim për certifikatë të notave	2.50€
2	Për certifikatë për diplomë dhe diplomë	5.00€
3	Për mbrojtje të diplomave master	100.00€
4	Për paraqitje të provimeve- master	2.50€
5	Për secilin provim të pranuar me rastin e tranferit	5.00€
6	Për ndërim fakulteti/departamenti	25.00€
7	Për kërkesë për transferim të notës/notave	0.50€
8	Për ndërrim të kartelës	10.00€
9	Për semestër për studentet në nivelin Bachelor	25.00€
10	Për semestër për studimet postdiplomike-Master	150.00€

**Tabela 20.** Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024 e strukturuar sipas shërbime administrative të ofruara për studentët e UIBM bazuar në UA 09/2021.

Pasqyra e shërbimeve administrative të ofruara për student dhe subjekteve afariste.

Nr.	EMERTIMI I TË HYRAVE VETANAKE	Planifikimi 2024
1	Vërtetim për certifikate të notave	1,230.00
2	Për vërtetim për diplome	450.00
3	Për diplome	700.00
4	Për ndërrim të kartelës	60.00
5	Për mbrojtje të diplomave master	2,200.00
6	Për provim diferencial	10.00
7	Për paraqitje të provimeve- master	0.00
8	Për provim pranues	0.00
9	Për secilin provim te pranuar me rastin e tranferit	23.00
10	Për nderim fakulteti/departamenti	50.00
11	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-bachelor për here të dytë	10,600.00
12	Për regjistrimin e semestrit të rregullt-master për here të dytë	7,650.00
13	Për shitjen e shërbimeve për komunitetin e biznesit dhe personave fizike	7,500.00
	<b>Gjithsej</b>	<b>30,473.00</b>

**Tabela 21.** Pasqyra e shërbimeve administrative të ofruara për student dhe subjekteve afariste.

## 5.2. Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën raportuese Janar-Qershor/2024

Për periudhën raportuese të hyrat vetanake janë realizuar në shumë prej 10,629.50 € dhe janë më të ulëta për 1,726.50 € në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2023.

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar-Qershor 2024.


Nr.	Planifikimi sipas Ligjit mbi Buxhetin për 2024	Të hyrat e bartuara nga viti fiskal 2023	Realizimi/inkasimi i THV për janar – qershor/2024	Alokimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar-Qershor/ 2024	Shpenzimi i THV për periudhën Janar-Qershor/2024
	1	2	3	4	5
1	30,473.00	3,994.00	10,629.50	9,847.00	0.00 €

**Tabela 22.** Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar-Qershor/2024.

Pasqyrë e realizimit të hyrave vetanake e strukturuar sipas njësive akademike:

Nr.	Përshkrimi i të hyrave pagesave	FAKULTETIN/NJËSIA AKADEMIKE						TOTALI
		FGJ	FTU	FIMK	F. EDUKIM	F. JURIDIK	F. EKONOMIK	
1	Për certifikatë të diplomës	5.00	-	110.00	30.00	-	70.00	215.00
2	Për certifikatë të notave	37.50	80.00	152.50	60.00	32.50	30.00	392.50
3	Për diplomë	100.00	120.00	130.00	30.00	-	70.00	450.00
4	Për diploma duplikat	-	-	25.00	-	-	-	25.00
5	Për mbrojtjen e diplomës së studimeve Master	400.00	1,100.00	-	-	-	-	1,500.00
6	Për kërkesë për transferimi të notës/notave	3.00	7.50	1.00	-	-	-	11.50
7	Për ndërrim të kartelës	-	-	-	10.00	20.00	10.00	40.00
8	Për semestër për studentet Bachelor	300.00	625.00	2,275.00	325.00	375.00	200.00	4,100.00
9	Për semestër për studimet postdiplomike-Master	2,150.00	1,250.00	495.50	-	-	-	3,895.50
10	GJITHSEJ	2,995.50	3,182.50	3,189.00	455.00	427.50	380.00	10,629.50

**Tabela 23.** Pasqyrë e realizimit të hyrave vetanake e strukturuar sipas njësive akademike për periudhën Janar-Qershor/2024.



**Figura 4.** Të hyrat vetanake të realizuara sipas njësive akademike Janar-Qershor/2024.

Të hyrat vetanake për periudhën Janar - Qershor 2024 janë: në Fakulteti i Gjeoshkencave ka të hyra prej 2,995.50 €, Fakulteti i Teknologjisë Ushimore ka të hyra prej 3,182.50 €, Inxhinierinë Mekanike dhe Kompjuterike – FIMK ka të hyra prej 3,189.00 €, Fakulteti i Edukimit ka të hyra prej 455.00 €, Fakulteti Juridik ka të hyra prej 427.50 € dhe Fakulteti Ekonomik ka të hyra prej 380.00 €.

Pasqyra krahasuese e realizimit të të hyrave për periudhën Janar-Qershor 2022/2024:

Nr	Periudha e raportimit	Realizimi i të hyrave	Indeksi i realizimit
1	Periudha janar-qershor/2022	14,743.50	
2	Periudha janar-qershor/2023	12,356.00	40.55 %
3	Periudha janar-qershor/2024	10,629.50	34.88 %

**Tabela 24.** Pasqyra krahasuese e realizimit të të hyrave për periudhën Janar-Qershor2022/2024.

## 6. TË HYRAT NGA DONACIONET

Universiteti i Mitrovicës është përfitues i shumë projekteve nga donatorët e ndryshëm në fushën e ngritjes profesionale për personelin akademik dhe studentëve në UIBM. Për këto qëllime për gjatë periudhës Janar–Qershor/2024 janë alokuar mjete në shumë 48,752.19 €, janë shpenzuar 22,434.03 € kurse shuma tjetër prej 26,318.16 € do të realizohet sipas dinamikës së definuar në projekte gjatë muajve në vazhdim të vitit 2024 dhe viteve të ardhshme.

Pasqyra e projekteve të strukturuar sipas donatorit, alokimit dhe realizimit për periudhën Janar-Qershor/2024.

Përshkrimi i projektit	Donacioni	Buxheti për vitin 2024	Buxheti i alokuar për vitin 2024	Mjetet e shpenzuara Janar-Qershor/2024	Zotim/Obligimet në pritje	Mbetja
		1	2	3	4	5=(2-4)
Përmirësimi i Kulturës të Kërkimeve në Arsimin e Lartë në Kosovë	Earnus+ ResearchCult	47.09	47.09	-	-	47.09
Studimi dhe Praktika e Punës në Agrok. dhe sigurinë e ushqimit	Erasmus+ DualAFS	9,491.33	9,491.33	9,345.30	1.00	145.03
Lëvizshmëria e stafit për mësimdhënie	Erasmus+ Mobilty for learners and staff	0.02	0.02	-	-	0.02
Përmirësimi i sigurimit të cilësisë së Universitetit	Erasmus+ QA-SURE	2,569.92	2,569.92	2,049.00	-	520.92
Nga kategoria Investime Kaptiale të projektit Përmirësimi i sigurimit të cilësisë së Universitetit	Erasmus+ QA-SURE	17,000.00	17,000.00		17,000.00	-
Ngritja e Profesionalizimit Dhe Cilësisë së Arsimit Fillestar	Erasmus+ QATEK	7,409.89	7,409.89	406.38	-	7,003.51
Nga kategoria Investime Kaptiale Ngritja e Profesionalizimit Dhe Cilësisë së Arsimit Fillestar	Erasmus+ QATEK	152.5	152.5	-	-	152.50



Metodat Inovative në Mësimdhënës të Matematikës	Erasmus+ iTEM	1,768.97	1,768.97	1,768.97	-	-
Zhvillimi i Cilësisë së Bashkëpunimit ndërkombëtarë	Erasmus+ QUADIC	7,426.01	7,426.01	6,006.00	-	1,420.01
Ngritja e kapaciteteve për të forcuar hulumtimet empirike të arsimit mbi kohezionin social dhe barazinë në Kosovë	Heras+ Research capacity building to strengthen Empirical Education Research on Social Cohesion and Equity in Kosovo - EduReaKos	231.18	231.18	203.11	-	28.07
Zhvillimi profesional për inxhinierët e së nesërmes	Heras+ Professional development for engineers of tomorrow - PDET.	2,655.28	2,655.28	2,655.27	-	0.01
<b>Gjithsej:</b>		<b>48,752.19</b>	<b>48,752.19</b>	<b>22,434.03</b>	<b>17,001.00</b>	<b>9,317.16</b>

**Tabela 25.** Pasqyra e projekteve të strukturuar sipas donatorit, alokimit dhe realizimit për periudhën Janar-Qershor/2024.

U.D. Drejtori për buxhet dhe financa

Burim Hasani